

KOMPANIA KOSOVARE PËR FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE SH.A.  
KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY J.S.C.  
KOSOVSKO PREDUZEĆE ZA SNABDEVANJE ELEKTRIČNOM ENERGIJOM D.O.O.

KESCO SH.A.  
Nr. 38 Dt. 08.12.2021  
HQ 1

Ymer Fejzullahu  
Kryesues i Bordit të ZRrE-së

Mesut Serhat Dinc  
Drejtor i Përgjithshëm  
KESCO sh.a

08 dhjetor 2021

**Lënda: Komentet e FShU-së ndaj Raportit Konsultativ të ZRrE-së lidhur me Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimet Operative të Furnizuesit me Shërbim Universal**

I nderuar z. Fejzullahu,

Ky dokument përmbledh komentet e Furnizuesit me Shërbim Universal (FShU) lidhur me Raportin Konsultativ të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) mbi Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimet Operative për periudhën 2022 –20254 të publikuar me datë 25 nëntor 2021.

FShU vlerëson mundësinë e dhënë për t'i ofruar komentet e tij ndaj çështjeve të rëndësishme të ngritura në Raportin Konsultativ të ZRrE-së dhe kërkon nga ZRrE-ja që të shqyrtojë qëndrimet mbi çështjet e ngritura në këtë raport përpara çdo vendimi përfundimtar lidhur me Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimet Operative për FShU-në.

Shprehim gatishmërinë tonë për të bashkëpunuar dhe për të diskutuar me ZRrE-në, të gjitha çështjet e ngritura dhe kundër-argumentet e ofruara në këtë raport.

Me respekt,

Mesut Serhat Dinc  
Drejtor i Përgjithshëm, KESCO sh.a



---

***Komentet e FSHU-së ndaj Raportit Konsultativ  
mbi Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimet Operative  
2022-2024***

---

## Përmbajtja

|    |                                            |   |
|----|--------------------------------------------|---|
| 1. | Hyrje .....                                | 3 |
| 2. | Marzha me pakicë.....                      | 3 |
| 3. | Niveli i lejuar për borxhet e këqija ..... | 5 |
| 4. | Kostot operative dhe të mirëmbajtjes ..... | 7 |
| 5. | Përfundim.....                             | 9 |

## 1. Hyrje

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (në vijim, ZRRE) përmes shkresës zyrtare nr. 497/21 të datës 12 tetor 2021 drejtuar KESCO-së si Furnizues me Shërbim Universal (në vijim, FSHU) ri-hapi procesin për shqyrtimin e Vlerave Hyrëse dhe Shpenzimeve Operative për periudhën 2022 –2024.

Në përputhje me kërkesat e shkresës, FSHU-ja ka parashikuar dhe plotësuar të dhënat sipas formateve të raportimit të dërguara nga ZRRE për Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimeve operative për periudhën 2022 –2024 dhe ka dorëzuar komentet dhe argumentet e shkruara përmes shkresë zyrtare nr. 31, më 1 nëntor 2021.

ZRRE më 25 nëntor 2021 publikon Raportin Konsultativ, i cili përmban propozimet fillestare për vlerat hyrëse dhe shpenzimet operative, ndaj të cilit të gjitha palët e interesit kanë mundësinë që ta analizojnë dhe ta komentojnë, në mënyrë që vlerësimi përfundimtar të jetë i saktë.

Në përputhje me kërkesat e përcaktuara në propozimin mbi vlerat hyrëse dhe afatin e përcaktuar në të, FSHU në dokumentin në vazhdim prezanton kundër-argumentet dhe arsyetimet lidhur me vlerat hyrëse dhe shpenzimet operative për Furnizuesin me Shërbim Universal, përkatësisht në pikat për të cilat ZRRE-ja mban qëndrim ndryshe nga kërkesat e FSHU-së.

## 2. Marzha me pakicë

Marzha e shitjes me pakicë përfaqëson kthimin që kërkon furnizuesi i energjisë elektrike për të tërhequr kapitalin e nevojshëm për të ofruar shërbimin e shitjes me pakicë tek konsumatorët e rregulluar. Konform Rregullës për të hyrat e FSHU-së, marzha me pakicë është përqindje fikse e cila ka për qëllim t'i siguroj FSHU-së përfitim të arsyeshëm që ta kompensojë për rreziqet që ndërmerr gjatë ofrimit të shërbimit standard për konsumatorët e rregulluar.

Marrë parasysh kushtet para privatizimit, Rregullatori përcaktoi marzhën me pakicë në 3% dhe si e tillë ishte e aplikueshme deri sot si vlerë hyrëse. Megjithatë, FSHU argumentoi se niveli i njëjtë duhet të vazhdohet edhe në këtë periudhë rregullative, ZRRE-ja në propozimin e vlerave hyrëse dhe shpenzimeve operative propozoi marzhën në nivel prej 2.54%, e cila mori parasysh mesataren e realizuar të kostove të marzhës ndaj kostove neto me shumicë, siç paraqitet në tabelën në vijim:

| Viti | Njësia | Kostot e marzhës | Kostot Bruto me shumicë | Kostot neto me shumicë |
|------|--------|------------------|-------------------------|------------------------|
| 2017 | €000   | 3,724            | 127,844                 | 124,133                |
| 2018 | €000   | 3,471            | 119,160                 | 115,700                |
| 2019 | €000   | 3,521            | 120,899                 | 117,367                |
| 2020 | €000   | 3,795            | 130,298                 | 126,500                |
| 2021 | €000   | 4,730            | 162,396                 | 157,667                |

| Kalkulimi                               | Njësia | Sasia   |
|-----------------------------------------|--------|---------|
| a) Kostot mesatare të marzhës 2013-2021 | €000   | 3,848   |
| b) Trendi i marzhës ne vitin 2022       | €000   | 151,663 |
| c= a/b Margjina                         | %      | 2.54%   |

Megjithatë, metodologjia e përdorur për caktimin e marzhës me pakicë mund të jap rezultate të ndryshme dhe nuk është koherente në periudhat e ndryshme kohore dhe njëkohësisht nuk merr parasysh faktorët që ndikojnë drejtpërdrejtë në përcaktimin e kostove të tregut të energjisë me shumicë.

Duke supozuar që ZRRE-ja ka zgjedhur të përdorë këtë metodologji të përcaktimit të marzhës me pakicë, atëherë duhet të marrim për bazë edhe trendin e viteve të mëparshme, për të pasur një trend më të besueshëm, e cila merr për bazë më shumë të dhëna historike. Bazuar në metodologjinë e përdorur nga ZRRE, rezultojnë që marzha me pakicë duhet të përcaktohet në vlerën 3.45%, siç paraqitet në tabelat vijuese.

| Viti | Njësia | Kostot e marzhës | Kostot Bruto me shumicë | Kostot neto me shumicë |
|------|--------|------------------|-------------------------|------------------------|
| 2013 | €000   | 4,816            | 165,353                 | 160,537                |
| 2014 | €000   | 4,724            | 162,183                 | 157,459                |
| 2015 | €000   | 4,738            | 162,679                 | 157,940                |
| 2016 | €000   | 4,547            | 156,110                 | 151,563                |
| 2017 | €000   | 3,724            | 127,844                 | 124,133                |
| 2018 | €000   | 3,471            | 119,160                 | 115,700                |
| 2019 | €000   | 3,521            | 120,899                 | 117,367                |
| 2020 | €000   | 3,795            | 130,298                 | 126,500                |
| 2021 | €000   | 4,730            | 162,396                 | 157,667                |

| Kalkulimi                               | Njësia | Sasia   |
|-----------------------------------------|--------|---------|
| a) Kostot mesatare të marzhës 2013-2021 | €000   | 4,230   |
| b) Trendi i marzhës ne vitin 2022       | €000   | 122,538 |
| c= a/b Margjina                         | %      | 3.45%   |

ZRRE-ja mund të përdor të dhëna historike më të shumta nëse të njëjtat i ka në dispozicion për të kalkuluar marzhën me pakicë. Vlen të theksohet se viti 2021 është viti ku e gjithë bota është përballur me një krizë energjetike, të cilat kanë shkaktuar një gjendje të jashtëzakonshme, që ka rezultuar me rritjen e kostos së çmimit me shumicë. Andaj, përdorimi i vitit 2021 në analizë duhet të merret me rezerva.

Është e rëndësishme të theksohet gjithashtu se Furnizuesi me Shërbim Universal në Kosovë ballafaqohet me rreziqe shumë më të mëdha se sa shërbimet në vendet tjera, veçanërisht vendet krahasuese si Evropa, Turqia apo Irlanda, të cilat ZRRE-ja i ka përdorur në krahasimet e saj. Raporti i Progresit për vitin 2021, vlerëson se Kosova është në një fazë të hershme të zhvillimit të një ekonomie tregu funksionale dhe se mjedisi i biznesit ende përballet me shumë sfida.<sup>1</sup> Për më tepër edhe metodologjitë e përdorura në vendet krahasuese dallojnë nga ato të aplikuara në Kosovë, p.sh. Turqia rishikon përshtatjet e rregullta në periudha 3 mujore. Gjithashtu, vetëm përcaktimi i marzhës me pakicë në vendet krahasuese të përdorura nga ZRRE-ja pa pasur parasysh të

<sup>1</sup> Raporti i Progresit për Kosovën, 2021, [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en)

gjitha kornizat rregullative dhe situatat sociale ekonomike-politike të vendeve në fjalë është e mangët dhe si e tillë nuk mund të përdoret si bazë krahasuese. E njëjta gjë citohet edhe në Rregullën për të Hyrat e FSHU-së Neni 13, pika 3.3 “....krahasimet me ndërmarrjet e ngjashme në Kosove dhe shtetet tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmërinë në mes të industrisë së energjisë elektrike në ato shtete me atë të Kosovës”.

ZRRE argumenton se Furnizuesi ka operime të sigurta megjithëse të gjitha kostot mbulohen përmes tarifave dhe se FSHU blen prodhimin nga KEK-u me prioritet. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se prodhimi i KEK-ut nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar konsumin në rritje, respektivisht furnizuesit është i ekspozuar ndaj importit dhe çmimeve që janë jashtë kontrollit të tij. Për më tepër, termocentralet e vjetra të njësive gjeneruese rezultojnë edhe me ndërprerje të paplanifikuara, të cilat gjithashtu ekspozojnë furnizuesin ndaj nevojës për import. Gjatë mesit të vitit 2021 ishim dëshmitar të rritjes së çmimeve të importit, të cilat tejkaluan çdo parashikueshmëri. Kjo rritje enorme e çmimeve të importit ndikoi negativisht tek operimet ditore të furnizuesit.

Është e rëndësishme gjithashtu të theksohet se edhe derregullimi i konsumatorëve në vitin 2017 ka ndikuar në fitimin neto të Furnizuesit me Shërbimit Universal, pasi kostot e shitjes me shumicë përbëjnë rreth 50% të MAR-it të aprovuar, ndërsa konsumatorët industrialë në tregun e parregulluar përbëjnë 10% të konsumit në Kosovë.<sup>2</sup> Respektivisht, raporti ndërmjet çmimit mesatar të blerjeve dhe çmimit mesatar të shitjes është zvogëluar që nga vitit 2017. Marrë në konsideratë derregullimin e ardhshëm sipas udhëzimit të ZRRE-së, fitimi neto aktual për Furnizuesin me Shërbim Universal do të jetë edhe më i ulët.

Në këtë kuptim, bazuar edhe në atë se çfarë kemi thënë më lartë, ne besojmë se në këtë periudhë, marzha me pakicë duhet të përcaktohet si 3% për 3 vitet e ardhshme. Përveç që kjo do të ofroj nxitje për FSHU-në për të vazhduar operimet e tij, kjo përqindje do të ofroj hapësirë të mjaftueshëm për konkurrencë ndërmjet furnizuesve të rinj dhe do të rris interesimin e konsumatorëve për të kaluar në tregun e parregulluar.

### 3. Niveli i lejuar për borxhet e këqija

Borxhi i keq është një vlerësim dhe nivel i arsyeshëm i borxheve të këqija të shkaktuara nga Furnizuesi i Shërbimit Universal gjatë një viti përkatës. Sipas nenit 16 të Rregullës për të hyrat e FSHU-së, kostot e lejuara të borxhit të keq do të vendosen nga Rregullatori gjatë përcaktimit të vlerave hyrëse dhe do të llogaritet duke aplikuar nivelin e lejuar të borxhit të keq në llogaritjen fillestare të MAR-it.

Në periudhën e parë rregullative, ZRRE-ja ka përcaktuar nivelin e lejuar për borxhet e këqija në 5% për 3 vitet e para dhe në 4% për 3 vitet e ardhshme (2012-2017). Niveli i njëjtë prej 4% vazhdoi të zbatohet deri më tani, ndërsa në propozimin e fundit Rregullatori propozoi nivelin e lejuar të borxheve nga 2.4 në vitin 2022 në 2% në vitin 2024, duke përdorur si referencë nivelin mesatar të realizuar për periudhën 2017-2021 sipas Pasqyrave Financiare.

| Komponentët e borxhit të keq                                | Analizë       | 2022        | 2023        | 2024        |
|-------------------------------------------------------------|---------------|-------------|-------------|-------------|
| a. Rënia në Vlerë e LI/A për vitet 2020-2021                | 2.21%         |             |             |             |
| b. Ndikimi i derregullimit të konsumatorëve (35kV dhe 10kV) | 0.15%         |             |             |             |
| <b>c=(a+b) Propozimi për lejimin e borxhit të keq</b>       | <b>2.36 %</b> | <b>2.4%</b> | <b>2.2%</b> | <b>2.0%</b> |

<sup>2</sup> Të dhënat aktuale për vitin 2021

ZRRE në propozimin e vet thekson se mos-inkasimi në kohë dhe kushte të paracaktuara nuk paraqet borxhet e këqija, por duhet të merret në konsideratë se furnizimi me energji elektrike nuk është si bizneset tjera, është biznes që ka nevojë për likuiditet të vazhdueshëm dhe të sigurt me qëllim që t'i përgjigjet obligimeve të tij financiare për gjithë sektorin e energjisë elektrike. Borxhi i keq i konsideruar nga Rregullatori bazohet në provizionet e prezantuara në Pasqyrat Financiare, të cilat prezantohen sipas parimeve të kontabilitetit (IFRS), ndërsa borxhi i keq në kornizën rregullative është parametër hyrës i cili vlerëson fuqinë e arkëtimit, duke marrë parasysh kohën dhe sjelljet e konsumatorëve kundrejt detyrimeve të tyre. Gjatë vlerësimit të borxhet e këqija duhet të merret në konsideratë edhe rënia e fuqisë arkëtuese ndër vite, siç paraqitet në tabelën e mëposhtme:

|      | 2013  | 2014  | 2015  | 2016  | 2017  | 2018  | 2019  | 2020  | 2021  | Total |
|------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| 2013 | 65.7% | 25.1% | 1.9%  | 1.1%  | 0.7%  | 0.5%  | 0.2%  | 0.1%  | 0.1%  | 95.5% |
| 2014 |       | 75.1% | 15.8% | 1.8%  | 1.0%  | 0.8%  | 0.5%  | 0.2%  | 0.2%  | 95.4% |
| 2015 |       |       | 76.2% | 14.7% | 1.7%  | 1.2%  | 0.7%  | 0.3%  | 0.3%  | 95.2% |
| 2016 |       |       |       | 75.4% | 15.6% | 2.0%  | 1.1%  | 0.5%  | 0.4%  | 94.9% |
| 2017 |       |       |       |       | 78.1% | 14.1% | 1.8%  | 0.7%  | 0.6%  | 95.3% |
| 2018 |       |       |       |       |       | 77.5% | 14.9% | 1.3%  | 0.9%  | 94.5% |
| 2019 |       |       |       |       |       |       | 79.3% | 12.9% | 1.8%  | 94.1% |
| 2020 |       |       |       |       |       |       |       | 76.7% | 19.4% | 96.1% |
| 2021 |       |       |       |       |       |       |       |       | 76.9% | 76.9% |

Siç mund të shihet në tabelën e mësipërme, fuqia arkëtuese bie nën 0% pas vitit të 4-të, përkatësisht nuk tejkalon vlerën prej 96% edhe me kalimin e viteve, fakt që paraqitet në totalin e arkëtimit duke marrë parasysh faturimin në vitin përkatës. Është faktike dhe shumë e qartë që maksimumi i arkëtimit është maturuar dhe mundësitë e përmirësimit të mëtejshëm janë neglizhuar. Andaj, të njëjtat duhet konsideruar si borxhe të këqija, konform definimit të dhënë në Rregullën për të Hyrat e FSHU-së, duke ruajtur incentivat dhe minimizuar rrezikun e rritjes të borxhit të keq.

Borxhet aktuale që konsumatorët i kanë ndaj furnizuesit KESCO deri në muajin nëntor 2021 janë mbi 121.4 milion € dhe prej tyre disa janë të pa-arkëtueshme, siç janë rastet sociale në vlerë prej 16.5 milion €. Siç mund të shihet nga tabela e mëposhtme rreth 50% e borxheve të tilla janë mbi 37 muaj të vjetra dhe konform tabelës së mësipërme, mundësia arkëtuese është shumë e vogël.

| Muajt | Të arkëtueshmet ('000 €) | Raporti i arkëtimit (%) |
|-------|--------------------------|-------------------------|
| 0-2   | 18,720                   | 15.4%                   |
| 3-6   | 11,799                   | 9.7%                    |
| 7-12  | 11,218                   | 9.2%                    |
| 13-24 | 11,639                   | 9.6%                    |
| 25-36 | 9,503                    | 7.8%                    |
| 37+   | 58,551                   | 48.2%                   |
| Total | 121,430                  | 100%                    |

Gjatë vlerësimit final është e rëndësishme që rregullatori të marrë parasysh gjithashtu rritjen e kostove të sistemit dhe/apo ndryshimet e pritshme në strukturën tarifore dhe ndikimet e tyre në borxhet e këqija, ashtu sikur edhe hapjen e tregut, të cilin në propozimin e tij rregullatori e ka marrë për bazë vetëm në vitin e parë

por jo edhe në vitet pasuese. Sipas udhëzuesit hapja e tregut do të bëhet në mënyrë graduale dhe ndikimi duhet të konsiderohet në normë rritëse, ashtu siç ka argumentuar KESCO në propozimin fillestar.

Marrë parasysh të thënat faktike, KESCO si Furnizues me Shërbim Universal kërkon nga rregullatori të bëjë rivlerësimin e borxheve të këqija konform kornizës rregullative, siç është argumentuar më herët në propozimin e FSHU-se për vlerat hyrëse, e paraqitur në tabelën vijuese:

|                                                          | 2022 | 2023 | 2024 |
|----------------------------------------------------------|------|------|------|
| <b>Kërkesa për nivelin e lejuar për borxhet e këqija</b> | 5.2  | 4.8  | 4.6  |

## 4. Kostot operative dhe të mirëmbajtjes

Në propozimin për vlerat hyrëse dhe shpenzimet operative, FSHU-ja ka parashikuar një rritje të lehtë në baza vjetore të kostove operative dhe të mirëmbajtjes (OPEX) në mënyrë që të pasqyrojë inflacionin e çmimeve përgjatë viteve, si dhe të reflektoj ndryshimet në treg, kërkesat legislative dhe reflektimin e kostove aktuale.

ZRRE-ja në Raportin Konsultativ ka parashikuar shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për periudhën 2022-2024 sipas mesatares së kostove të realizuara në vitet 2016-2020. Duke marrë parasysh se në vitin 2018 shpenzimet e 'tjera' operative janë në nivele jashtë trendit të shpenzimeve të periudhës 2016-2020, të njëjtat nuk janë konsideruar në vlerësimet finale të ZRRE-së. Megjithatë është e rëndësishme të sqarohet se shpenzimet e menaxhmentit (në kuadër të zërit 'shpenzime tjera') të cilës i referohet ZRRE-ja, i atribuohet procesit të liberalizimit të tregut. Procesi i liberalizimit të tregut ka shtuar nevojën për konsulencë të jashtme, përgatitje të stafit dhe sistemeve brenda kompanisë, e cila ka ndikuar në një rritje më të theksuar të kostove në krahasim me vitet tjera. Largimi i kostove të tilla nga mesatarja e supozuar jep konkluzione të gabuara marrë parasysh se në vazhdimësi na presin procese tjera për të cilat mund shtohet nevoja e konsulencës si mbështetje e menaxhmentit.

Kjo mesatare e realizuar sipas shpjegimeve të mësipërme, është supozuar nga ZRRE-ja si vazhdimësi e pritshme e shpenzimeve operative për periudhën e ardhshme rregullative, mbi të cilat ZRRE ka aplikuar edhe një faktorë të efikasitetit.

Gjatë vlerësimit të kostove operative, Rregullatori fillimisht i ka ndarë ato në dy kategori: kostot e kontrollueshme dhe kostot e pakontrollueshme. Në kostot e pakontrollueshme, të cilat varen nga çmimet e tregut dhe ndaj të cilave FSHU nuk mund të ketë ndikim të ndjeshëm, ZRRE ka përfshirë vetëm kostot për shërbimet përbashkëta dhe qiranë, duke lënë në kategorinë e kostove të kontrollueshme shpenzimet e sigurimit të aseteve, punëtoreve, etj., të cilat gjithashtu përcaktohen nga çmimet e tregut, p.sh. shpenzimet e sigurimit gjatë vitit 2021 kanë shënuar rritje për 34%, kosto këto të cilat janë jashtë kontrollit të FSHU-së. Ndërsa faktorin e efikasitetit prej 0.5% e ka aplikuar tek të gjitha kostot e kontrollueshme (përfshirë sigurimet), duke rezultuar kështu me propozimin final të ZRRE-së për shpenzime operative prej rreth 5 milion €/vit, siç tregohet në tabelën më poshtë:

| Përshkrim                | 2022         | 2023         | 2024         |
|--------------------------|--------------|--------------|--------------|
| Efikasiteti              | -            | -0.47%       | -0.47%       |
| Opex i kontrollueshëm    | 3,671        | 3,688        | 3,705        |
| Opex i pa-kontrollueshëm | 1,499        | 1,499        | 1,499        |
| <b>Total</b>             | <b>5,169</b> | <b>5,187</b> | <b>5,204</b> |

Është e rëndësishme të theksohet se për dallim nga Rregulla për të hyrat e OST/OT dhe OSSH-së, Rregulla për të Hyrat e FSHU-së nuk ka paraparë si vlerë hyrëse faktorin e efikasitetit. Ne pajtohemi se faktori i efikasitetit nxit efikasitetin për kursimet e shpenzimeve operative, mirëpo FSHU-ja edhe në propozimin e dërguar në ZRRE për parametrat rregullativ ka theksuar se operon brenda buxhetit të lejuar duke krijuar efikasitetin kurdo që është e mundur në zërat e caktuar në mënyrë që të jetë në gjendje të mbulojë kostot e rritura në zërat tjerë.

Në propozimin e vlerave hyrëse, FSHU argumentoi se mesatarja e humbjes së FSHU-së sipas shpenzimeve operative të lejuara për konsumatorë është afro 9% për përdhën 2017-2021, kjo për faktin se numri i konsumatorëve është rritur vazhdimisht përderisa shpenzimet operative nuk janë rritur për të reflektuar këtë rritje të numrit të konsumatorëve. ZRRE në propozimin e vlerave hyrëse thekson se ka pak arsye për të supozuar se kostot e OPEX-it bazë duhet të rriten për shkak të rritjes së numrit të konsumatorëve, megjithatë OPEX-i i lejuar nga rregullatori që nga viti 2011 i ndryshuar tutje vetëm për normë inflacion dhe një rritje e vogël gjatë vitit 2018, nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet operative që përfshijnë: modernizimin e qendrës së thirrjeve, përmirësimin e shërbimit të konsumatorëve (e cila arrihet përmes pajisjeve dhe programe të reja, trajnime të punëtorëve, etj.). Pra, edhe nëse krahasojmë shpenzimet operative aktuale nga vitit 2018 në 2021 kemi një ndryshim prej 23%, që dëshmon se FSHU-ja ka arritur optimizimin maksimal, për të cilat humbje FSHU-ja nuk është kompensuar përmes OPEX-it të dhënë dhe të cilat do të jenë problematike për t'u arritur nëse ZRRE aplikon faktorin e efikasitetit.

ZRRE në vlerësimet e veta nuk e ka marrë parasysh as kërkesën e FSHU-se për rritjen e pagave, me arsyetimet se kostot e personelit të KESCO janë azhurnuar gjatë shqyrtimit tarifor në vitin 2018 me qëllim që të jenë të krahasueshme me kostot e personelit të të licencuarve të tjerë. FSHU rithekson se azhurnimi i këtyre kostove nuk ka reflektuar me nivelizimin e pagave me të licencuarit e tjerë, të cilat janë së paku 25% më të ulëta kur krahasohen me të licencuarit tjerë në sektorin publik të energjisë. Duke marrë parasysh rendësin e procesit në të cilin jemi dhe ndikimin që pritet të ketë përcaktimi i parametrave për tri vitet e ardhshme, kërkojmë nga ZRRE të reflektoj kostot e kërkuara nga FSHU-ja pasi që konsiderojmë se është e padrejtë dallimi në paga për punonjësit e FSHU-së në raport me të licencuarit e tjerë dhe njëkohësisht të parandalojmë largimin e punëtorëve të kualifikuar.

Marrë parasysh të lartë-thënat dhe nevojat e analizuara në detaje lidhur me kërkesat për zhvillimet e pritshme në tre vitet e ardhshme, OPEX-i i propozuar nga FSHU-ja për të siguruar operim të qëndrueshëm dhe funksional gjatë viteve 2022-2024 është si në vijim, e cila është argumentuar edhe gjatë propozimit të vlerave hyrëse nga FSHU-ja:

|                                                        | 2022 | 2023 | 2024 |
|--------------------------------------------------------|------|------|------|
| <b>Kërkesa për Shpenzime operative dhe mirëmbajtje</b> | 6.80 | 6.87 | 6.89 |

ZRRE duhet të ketë parasysh se periudha e ardhshme rregullative që po e pret FSHU-në do të jetë mjaftë sfiduese, duke marrë për bazë edhe rritjen e çmimeve për secilin sektor të ekonomisë e cila do të reflektohet edhe me rritjen e kostove operative të domosdoshme për funksionim normal të kompanisë, prandaj FSHU kërkon nga ZRRE të bazoj gjykimet e veta duke marrë për bazë edhe kostot e pritshme, konform informatave të njohura në kohën e aplikimit.

## 5. Përfundim

Duke marrë parasysh arsyetimin e komponentëve për parametrat rregullativ të paraqitura në këtë dokument FSHU beson se kërkesat e paraqitura janë të drejta dhe më e rëndësishmja janë të domosdoshme për Furnizuesin me Shërbim Universal.

Rregullatori konform nenit 15 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë ka për obligim të balancoj interesat e konsumatorëve dhe të licencuarve dhe të mbulojë koston reale të furnizimit të energjisë elektrike, duke përfshirë kostot e gjenerimit, koston marginale afatshkurtër, duke reflektuar portofolin e plotë të gjenerimit, investimet e domosdoshme, shkallën e duhur të kthimit, koston e importeve, koston e shërbimeve të furnizimit, si dhe borxhet e këqija.

Marrë parasysh se Furnizuesi me Shërbim Universal ka mbyllur vitin 2019 dhe 2020 me humbje financiare, është përballur me probleme arkëtimi gjatë pandemisë COVID-19, dhe sfidohet me krizën energjetike financiare gjatë vitit 2021, të njëjtit i duhet kohë për t'u rikuperuar me qëllim të krijimit të stabilitetit financiar. Andaj mos-reflektimi i duhur i vlerave hyrëse dhe shpenzime operative gjatë periudhës së dytë rregullative do ta rrezikoj seriozisht mbarëvajtjen e operimeve dhe përkatësisht qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike.

Qëllimi i FSHU-së pa dyshim është të ofroj shërbime të një cilësie të lartë për konsumatorët e vet dhe FSHU vazhdimisht është duke punuar në këtë drejtim, andaj për të përmbushur edhe më tej qëllimin dhe objektivat e veta, FSHU-së i duhen që kostot e nevojshme për operim të lejohen nga Rregullatori.